L I G J
Nr.9058, datë 20.3.2003

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7703, DATË 11.5.1993 "PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", I NDRYSHUAR ME LIGJET NR.7932, DATË 17.5.1995; NR.8286, DATË 16.2.1998; NR.8392, DATË 2.9.1998; NR.8575, DATË 3.2.2000; NR.8776, DATË 26.4.2001; NR.8852, DATË 27.12.2001 DHE NR.8889, DATË 25.4.2002

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në nenin 31/1 bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:

"Pensioni i reduktuar është pjesë e pensionit të plotë dhe mbetet i reduktuar gjatë gjithë kohës së përfitimit. Ky pension llogaritet duke zbritur nga pensioni i plotë shumën që del nga shumëzimi i numrit të muajve të përfitimit të pensionit, para mbushjes së moshës së përcaktuar në nenin 92, me koeficientin mujor të reduktimit. Koeficienti i reduktimit të pensionit të plotë të pleqërisë, për personat që plotësojnë kushtet e parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni, është 0.6 për qind në muaj.".

Paragrafi i fundit shfuqizohet.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.3814, datë 8.5.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu